



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
Komisioni Institucional i Zgjedhjeve

V E N D I M

Nr. 04 , Datë 17 / 03 /2021

“Për rihapjen e procesit të vetëkandidimit për anëtarë të KZF në Fakultetin e Shkencave të Natyrës të UT-së”

Në zbatim të Ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe të Rregullores “Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet drejtuese dhe Senatin Akademik të Universitetit të Tiranës”, Kreu II, neni 7, si dhe bazuar në faktin që numri i aplikantëve për anëtarë të KZF-së në FSHN të UT-së, rezulton të jetë më i vogël se numri i anëtarëve të saj, përcaktuar në Vendimin nr. 3, datë 01.03.2021, Komisioni Institucional i Zgjedhjeve në UT;

VENDOSI:

1. Rihapjen e procesit të vetëkandidimit për anëtarë të Komisionit të Zgjedhjeve në Fakultetin e Shkencave të Natyrës në Universitetin e Tiranës.
2. Regjistrimi i kandidatëve për këtë komision, fillon në datën 18.03.2021 dhe përfundon në datën 19.03.2021, nga ora 08.00 – 15.00. Regjistrimi i kandidatëve kryhet pranë Sekretarisë Teknike të KIZ, pranë Rektoratit të UT-së, ose elektronikisht, në adresën kizut2021@unitir.edu.al, sipas formularëve bashkëngjitur këtij vendimi.
3. Aplikantët duhet të paraqesin këtë dokumentacion:
 - A. Personeli akademik:
 - Vërtetim nga struktura e Burimeve Njerëzore të njësisë kryesore, ku të specifikohet edhe njësia bazë ku bën pjesë;
 - Fotokopje të dokumentit të identifikimit.

B. Studentët:

- Vërtetim nga njësia ku studenti ndjek programin e studimeve, shoqëruar me listën e notave të përditësuar;
- Fotokopje të dokumentit të identifikimit.

C. Sekretar të KZF-së:

- Vërtetim nga struktura e Burimeve Njerëzore të njësisë kryesore;
- Fotokopje të dokumentit të identifikimit.

4. Vendimi dërgohet për zbatim në Fakultetin e Shkencave të Natyrës të UT-së.
5. Ky Vendim të publikohet në mjedise të dukshme të Fakultetit të Shkencave të Natyrës, në faqen e tij zyrtare dhe në faqen zyrtare të UT-së.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI INSTITUCIONAL I ZGJEDHJEVE

- | | |
|---------------------|-----------|
| 1. Edvin Lame | (Kryetar) |
| 2. Xhensila Kadi | (Anëtare) |
| 3. Alnida Koroshi | -//- |
| 4. Shaniko Allajbeu | -//- |
| 5. Arjan Tushaj | -//- |
| 6. Eljon Doçe | -//- |
| 7. Dhurata Saraçi | -//- |

